

Bordi i Drejtoreve të KRU "Mitrovica" Sh.A bazuar në nenin 34 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe Ligji Nr.05/L-009, nenit 4 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr.03/L-212, si dhe bazuar në nenin 7 në Statutin e Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A në mbledhjen e mbajtur me datë 04.03.26 aprovoi këtë:

**RREGULLORE NR. 536 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR. 2453 MBI SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS TË KOMPANISË RAJONALE UJËSJELLËSI "MITROVICA" SH.A. NË MITROVICË**

**Neni 1**

Qëllimi i kësaj Rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullore nr. 2453 mbi sistematizimin e vendeve të KRU,, Mitrovica,, Sh. A.

**Neni 2**

Plotësohet Rregullorja mbi sistematizimin e Vendeve të Punës për pozitën Zyrtar/e i/e Auditimit të Brendshëm ku largohet kriteri Auditor i Certifikuar (Obligative), ndërsa tek përgatitja profesionale shtohet edhe Ligji për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (Ligji Nr. 06/L-021), kriteret tjera mbeten të njëjta.

**Neni 3**

Me këtë Rregullore bëhet ndryshim plotësimi i rregullores përkatëse, për tu harmonizuar me plotësimet e përdorura në këtë Rregullore.

**Neni 4**

Kjo Rregullore hynë në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga Kryesuesja e Bordit të Drejtoreve të KRU" Mitrovica" Sh.A.- Mitrovicë si dhe publikimit të saj në ueb-faqen e Kompanisë.

KRU,, Mitrovica,, Sh.A - Mitrovicë

Kumrije Kelmendi Aliu - Kryesuesja e Bordit të Drejtoreve

